AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional**
**"Agroturizëm dhe Mikpritje"**
**ofruar nga**
**institucioni i arsimit të lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Nevila Çinaj
2. Prof.asoc.dr. Çlirim Duro

Qershor /2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për programin e studimit me karakter profesional në "Agroturizëm dhe Mikpritje" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Bujqësor i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Program profesional në "Agroturizëm dhe Mikpritje" |
| 4 | VKM i licencimit: | - |
| 5 | Urdhëri i MAS | UMASR nr. 245, datë 19.07.2021 |
| 6 | Regjistrimi i formës së diplomës: | Në proces |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite /4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 5 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 16 PAE/ 5 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 57 Studentë |
| 19 | Komente te tjera : | - |

**PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me VKM Nr. 548, datë 28.07.1951, si fillim Institut i Lartte dhe me VKM nr. 166, datë 28.09.1991 mori statusin Universitet.
Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA), me Nr 59, datë 16.12.2021 me kohëzgjatje 5 vite akademike vlefshmëri deri më **15.12.2026**

UBT përbëhet nga pesë njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Fakulteti i Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Fakulteti i Mjeksisë Veterinare.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit përbëhet nga gjashtë departamente.
Departamentet, pjesë e strukturës së FEA-s, janë:

1. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit;
2. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikat e Zhvillimit Rural;
3. Departamenti i Financë - Kontabilitetit;
4. Departamenti i Matematikës dhe Infomatikës;
5. **Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural•**
6. Departamenti i Gjuhëve të Huaja;

Programi i studimit profesional dy vjecar "Agroturizëm dhe Mikpritje" është hapur me urdher te MAS Nr. 245, datë 19.07.2021, me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 2 vite akademike. Ky program studimi i përket nivelit të 5-të, të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti **i Menaxhimit të Turizmit Rural**, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.
Numri total i studentëve për vitin akademik është 57 studentë.
Ky program studimi profesional dy vjecar,është për herë të parë në proces akreditimi.

**Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit profesional dy vjecar "*Agroturizëm dhe Mikpritje*", i ofruar nga departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të nje programi profesional dy vjeçar, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.
Vlerësimi i jashtëm bazuar tek standardet e cilësisë për këtë program studimi është fokusuar në 5 fusha vlerësimi:

1. Ofrimi i programit të studimit;
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
3. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre

Në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e Vlerësimit,i miratuar nga Bordi i Akreditimit (BA) dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, pasqyrohet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga koordinatori teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS dhe gjatë vizitës në institucion.
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga:

**Dr.Nevila ÇINAJ**
**Prof.Asoc.Dr. Çlirim DURO.**

Koordinatore teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aviola BARDHI

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program

studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, pa-anshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UBT.
GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 31/05/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 38/52 Prot., datë 01/06/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.
UBT kthehu përgjigje me shkresë zyrtare Nr. 516/ 4 Prot., datë 19/06/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

## Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në "Agroturizëm dhe mikpritje"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me VKM-në Nr.548, datë 28.07.1951 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr 59, datë 16.12.2021, për një afat 5 vjeçar, deri më 15.12.2026.<br>Programet që ofron, nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit. Programi 2 vjecar profesional në "Agroturizëm dhe mikpritje", synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, pasi është hartuar në përputhje me Legjislacionin në fuqi te Republikes së Shqipërisë.<br>**[Ligji nr. 80/2015 datë 22.7.2015, Statuti i UBT, Rregulloren e studimeve universitare të UBT, Rregullloren e studimeve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Vendimi i Bordit te Akreditimit ]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL, programet e ofruara, synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin, objektivat si dhe fushën e veprimtarisë se UBT-se.<br><br>**[Statuti, Rregulloren e studimeve universitare te UBT]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | UBT ka fokusuar veprimtarinë e tij në katër drejtime kryesore:<br>1. shkencave humane,<br>2. shkencave ekonomike,<br>3. shkencave natyrore,<br>4. shkencave bujqësore,<br>Ky program studimi është hartuar ne kuadrin e e ketyre drejtimeve dhe ne zbatim të strategjisë për zhvillim te vete institucionit<br>**[Plani strategjik UBT 2016-2025]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. | Hapja e programit profesional "Agroturizëm dhe Mikpritje" sipas dokumentacionit te paraqitur nga IAL-ja, është mbeshtetur në një studim tregu në nivel kombëtar. Nga ky studim per kete akreditim vleresuam nje pjese shume te rendesishme, intervistat dhe pyetësorë me dy grupe te interesuarish; maturantët dhe bizneset turistike. Në këte program studim ka nje analizë të strategjive te ndryshme, të dhënave statistikore, publikim dhe botime te ndryshme që tregonin tendencën e zhvillimit të turizmit ne Shqiperi.<br>**[Evidenca nr.74, analize e tregut te punes]** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Sipas legjislacionit në fuqi, përgjegjës për programin e studimit "Agroturizëm dhe Mikpritje" është departamenti i menaxhimit dhe i turizmit rural (DMTR), pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit te UBT. Ky departament sipas RVB-së dhe dokumentacionit mbështetës ka një eksperiencë 12 —vjeçare në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor. DMTR ofron nje program studimi ne ciklin e parë të studimeve dhe një në ciklin e dytë të studimeve (master profesional). Ky program që është nën vlerësim, është i mbështetur nga personel akademik me eksperiencë, me titujt dhe grada shkencore dhe me trajnime të vazhdueshme. **[Vizita në institucion RVB fq 5].** | | | |
| **Kriteri 6.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Duke ju referuar RVB-se dhe dokumentacionit mbështes për këtë proces vlerësimi theksojmë se fusha e përgjithshme dhe ajo kërkimore -shkencore e DMTR eshte "Ekonomi dhe Agrobiznes" ndërsa ajo specifike është "Turizmi Rural". Kodifikimi i programit te studimit ishte ne proces aplikimi ne MAS.<br><br>Per sa me siper edhe fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Agroturizem dhe Mikpritje eshte në përputhje me fushën e kerkimit te departamentit.<br><br>**[Rregullore e fakultetit, fq 40-41]** | | | |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi I.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Departamenti për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Agroturizëm dhe Mikpritje, ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda departamentit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive (Grupeve Mësimore-Kërkimore, GMK) dhe personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Përgjegjësi i departamentit realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve mësimore kërkimore dhe stafit akademik ndërkohë që dekanati siguron bashkëpunimin ndërmjet departamenteve. Grupet mësimore janë përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies dhe organizojnë punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies per kete program studimi. Veprimtaria mësimore-kërkimore e grupeve mësimore dhe e departamentit për çdo vit |

| | |
|---|---|
| | akademik analizohet dhe vlerësohet nga të gjithë anëtarët e asamblesë së departamentit dhe i përcillet dekanatit per procedure. **[Analiza Mësimore- Kërkimore DMTR 2021-2022, Analiza Mësimore- Kërkimore 2021-2022 FEA]** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendosmarrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | UBT per realizimin e objektivave te tij, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të UBT janë të listuara në evidencën numër 76 të RVB-së.<br>**[Liste marreveshjeve institucionale te UBT]** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. | Institucioni dhe njësitë përbërëse të tij kanë një listë me marrëveshje të realizuara me kompani apo institucione të ndryshme në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentëve.<br>Edhe për programin e studimit "Agroturizëm dhe Mikpritje" ekzistojnë disa marrëveshje për praktikën profesionale. Nga këto marrëveshje, GVJ vlerësoi faktin, që ato conin në atë nivel që Studentët do të kryejnë praktikën, të jetë sa më i lidhur me fushën e studimit. **[Evidenca 91, Lista e Marrëveshjeve]**<br>*Shënim: Në momentin e vizitës në institucion, nuk ishte zhvilluar akoma praktika profesionale.* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Departamenti kryen analizave vjetore në të cilat merren në hollësi një sërë çështjesh, ndër të cilat dhe ajo e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Analiza e përvitshme e punës mësimore dhe shkencore që departamenti realizon, trajton në detaje kontekstin e bashëpunimit të personelit akademik dhe të aspekteve pozitive që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka ky program.<br>**[Evidence 65 Analiza mesimore kerkimore DMTR ]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. | Në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve, UBT-ja ka krijuar Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA), detyrë e kësaj strukture është realizimi i aktiviteteve të ndryshme organizata, institucione, biznese të ndryshme për të bërë të mundur punësimin e studentëve. Programi i studimit "Agroturizëm dhe Mikpritje" nuk ka diplomuar asnjë student, keshtu që nuk kemi të dhëna për këtë pikë.<br>**[Evidence perfomanca e QKA]** |
| **Konkluzione** | *UBT ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas në funksion të realizimit të programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi I.3<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Universiteti Bujqësor i Tiranës ka hartuar proçedura dhe politika në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. UBT në rang institucional, ka krijuar strukutren e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura qe merret me sigurimin e cilesise eshte Drejtoria e vleresimit te brendshem dhe e sigurimit te cilesise (DVBSC). Ne cdo Njesi Kryesore (edhe ne FEA) eshte ngritur dhe njësitë e sigurimit të cilësisë (NJSC). Kjo strukure e sigurimit te cilesise (ne nivel institucional dhe njesie kryesore) mbeshtetet ne punen e saj, ne parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br>**[Ligji i arsimit te larte 80/2015, Kodi i Cilesise, Statuti i UBT dhe Rregullore e sigurimit te cilesise].** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Institucioni ka të ngritur strukura qe jane në funksion te sistemit te brendshëm të sigurimit të cilësisë te citura me larte.<br>Permiresimi i cilesise se mesimdhenies eshte nje nga objektivat primare te politikes ne UBT.<br>DVBSC dhe NJC koordinojne veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në nje sistem kapilar duke u shtrirë në cdo program studimi të ofruar.<br>Menaxhimi i cilësisë përfshin:<br>1. procesin e mësimdhënies,<br>2. kërkimit shkencor,<br>3. programet që ofron,<br>4. shërbimet,<br>5. studentët,<br>6. personelin akademik,<br>7. burimet për garantimin e cilësisë,<br>8. monitorimin e mësimit dhe kërkimi<br>9. Ecurinë e studentëve pas diplomimit.<br>Ashtu si janë krijuar struktura të posacme në nivel universiteti dhe fakulteti, ashtu edhe ekzistojnë standarte të hartuara nga DVBSC. Gjithashtu për sigurimin e cilësisë vihen në dispozicion burimet e nevojshme si dhe përcaktohen treguesit e matjes dhe monitorimit pa prekur autonominë dhe lirinë akademike të personelit akademik.<br>**[Statut i UBT, rregullore e Sigurimit te Cilesise, Manuali i Sigurimit të Cilësisë ]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve | UBT nepermejt DVBSC, përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Nga takimi më anëtarë të NJSC (dhe shqyrtimi i RVB-së) na u bë me dije se përdoren disa instrumeta për realizimin e procesit të vlerësimit si:<br>• Nëpërmjet anketimit realizohet vlerësimi për çdo lëndë të |

| | |
|---|---|
| të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | çdo pedagogu nga studentët;<br>• Përdorimi i fokus grupeve;<br>• Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit;<br>• Follow up me stafin etj.<br>UBT është një institucion i arsimit të lartë i akredituar me vendim te Bordit te Akreditimit. Ai e siguron cilesine nepermejt akteve ligjore, nenligjore dhe akteve te tij te brendshme. Universiteti i nënshtrohen kontrollit të brendshëm dhe atij të jashtem institucional dhe atij te programeve te studimit sipas periudhes kohore te percaktuar nga ASCAL.<br>**[Vizita në institucion, Statut i UBT, rregullore e sigurimit te cilesise, Manuali i sigurimit të cilësisë]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira. | UBT dhe strukturat përbërëse të tij, përdorin tregues të ndryshëm për të matur dhe vlerësuar arritjet e studentëve, personelit akademik dhe atij administrativ. Gjithashtu aktiviteti i mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve ka standarte të qartë dhe të matshëm. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. UBT përmes proceseve te vlerësimit të jashtëm të akreditimit realizon sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë, i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues.<br>**[Vizita në institucion, Statut i UBT, rregullore e sigurimit te cilesise, Manuali i sigurimit të cilësisë ]** |
| **Konkluzione** | *UBT ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1**<br><br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Ne UBT, programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas sistemit Evropian te Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të programit të studimeve profesionale 2 vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje" duhet të grumbullojë 120 kredite. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi në UBT me kohë të plotë është 60 kredite. Ky program mësimor është në përputhje me legiislacionin në fuqi. Plani mësimor i programit nen vleresim përfshin: emërtimin e programit, të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat formuese të programit, tipet e veprimtarive formuese, (leksione, seminare, punë laboratori, ushtrime, projekte, detyrat e kursit, ekskursionet mësimore, etj), raportin e orëve mësimore, planin mësimor, kreditet e detyrueshme të studimit, kreditet për çdo veprimtari formuese, kohëzgiatjen e programit te modulit, vlerësimin e shlyerjes së detyrimeve, (mënyra dhe pesha e vlerësimit te shlyerjes së detyrimeve) dhe literatura.<br><br>**[ VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar, evidenca nr. 43 Plani mësimor studimeve professionale 2 vjecare agroturizëm dhe mikpritje]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale. | Nga vleresimi i dokumentacionit per programin "Agroturizëm dhe Mikpritje", GVJ konstaton se ky eshte nje program studimi me karakter professional, dhe i perket nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve, studneti pajiset me Diplomë Profesionale dyvjecare. Programi i studimit ofron elementet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aftësive në fushën e turizmit rural dhe më specifikisht në agroturizëm dhe shërbimet shoqëruese të tij. Studimet në këtë program synojnë të sigurojnë njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integrimit të mësimit me praktikën. Ky program studimi ka për mision dhe synon të ofrojë mundësi më të mëdha karriere në pozicionet si menaxher të bizneseve të agroturizmit, administrator i bizneseve të hotelerisë e mikpritjes, specialist në bizneset që ndryshe njihen si ndërmjetësit në tregun turistik. Ky program formimi profesional, synon të sigurojë nje nivel njohurish dhe aftësish praktike të domosdoshme për të realizuar me sukses aktivitetet që kryhen në një fermë agroturistike.<br><br>**[Evidence 69 Rregullore e programit te studimit ]** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të | Programi "Agroturizëm dhe Mikpritje" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në |

| | |
|---|---|
| studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. | përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.<br>Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave dhe eksperiencave të studentëve jashtë universitetit e të tjera, synohet që t'u japin studentëve njohuri të përparuara në fushë si dhe koncepte për të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.<br>**[Evidence 69 rregullore e programit te studimit ]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit në "Agroturizëm dhe Mikpritje" ka të përcaktuar sipas legjislacionit ne fuqi veprimtaritë formuese te tij. Ai ofron veprimtari fomuese që klasifikohen ne:<br>A- Lënde Bazë (*Përgatitje metodologjike dhe kulture e përgjithshme*) = 18 ECTS<br>B- Lëndë Karakterizuese (*Përgatitje për disiplinen qe karakterizon programin, lëndët praktike*) = 66 ECTS<br>C- Lëndë Ndërdisiplinore (*Integruese - nëndisiplina, grup-lëndë me zgjedhje*) = 15 ECTS<br>D- Lëndë Plotësuese (*Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale)*= 17 ECTS<br>E- Detyrime Përmbyllëse = 4 ECTS<br>Secili prej moduleve ka të përcaktuar temat që do të trajtohen, përmbajtjen e tyre, objektivat e të nxënit ose formuese, kreditet, mënyrat e vlerësimit, literaturë bazë dhe të sugjeruar për studentët etj.<br>**[Evidence 71 Struktura, plani mësimore 2022-2023, RVB fq 56-57]** |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e organizimit të studimeve per kete program studimi eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Sipas ketij legjislacioni (te cituar ne fund te paragrafit), në programin e studimit profesional, "Agroturizëm dhe Mikpritje" kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regiistruar personat që kanë përfunduar shkollën e mesme ne Republiken e Shqiperise. Nga vizita ne institucion dhe dhe shqyrtimi i dokumentacionit te pranimit, studentet fitues ishin pranuar duke plotesuar kriteret e meposhtme:<br>1. Renditjen bazuar në notën mesatare në arsimin e mesëm;<br>2. Kuotat e paracaktuara nga Njesia kryesore;<br>Programi financohet nga të ardhurat e UBT-s. Edhe në këtë program studimi si ne te gjithe programet e UBT-se, aplikohet politika e mbështetjes financiare për studentët studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret, e parashikuara në legjislacionin ne fuqi.<br>**[ VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar, Statuti i UBT, VKM nr 903 datë 21.12.2016, ndryshuar, Evidence. 59, kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022, RVB fq. 58]** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë | Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është unik në një numër të konsiderueshëm programesh studimi që ofron. Ndër to është edhe programi i studimit profesional, "Agroturizëm dhe Mikpritje", pjesë |

| | |
|---|---|
| studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | e Departamentit me të njëjtin emërtim. Një program i tillë nuk gjendet në Institucionët e tjera të Arsimit të Lartë (IAL), si në ato publike, ashtu edhe në ato private. Per sa me siper nuk kemi te dhena qe te kete nje program tjeter te ngjashem per te bere te mundur per te gjykuar permbajten e perbashket e cial duhet te jete se paku 70%.<br>**[Vizita ne institucion, RVB fq. 31]** |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Bazuar ne legjislacionin ne fuqi, programi i studimit në "Agroturizëm dhe Mikpritje", ishte ne proces te marrjes se kodit ne MAS.<br>**[ Udhezimi i MAS nr. 31, date 15.11.2022]** |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit* profesional, *"Agroturizëm dhe Mikpritje", organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore te UBT-se.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit përbëhet nga gjashtë departamente.<br>Departamentet, pjesë e strukturës së FEA sjanë:<br>7. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit;<br>8. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikat e Zhvillimit Rural;<br>9. Departamenti i Financë - Kontabilitetit;<br>10. Departamenti i Matematikës dhe Infomatikës;<br>11. **Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural•**<br>12. Departamenti i Gjuhëve të Huaja;<br>Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural si pergjegjes për programin e studimit "Agroturizëm dhe Mikpritje" përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.<br>**[ Evidence 28 Rregullore FEA, RVB fq. 32 ]** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel | Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural përbëhet nga dhjetë personel akademik me kohe te plote. Ky departament përvec personelit akademik të brendshëm ka edhe pedagogë të ftuar, numri i të cileve ne vitin e fundit është shtatë, të cilët janë rekrutuar në përputhje më kriteret dhe nevojat e përcaktuara. Departamenti ka |

<table>
<tr><td>ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</td><td colspan="4">edhe një person staf administrative ndihmës. Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural është i organizuar në dy Grupe Mësimore Kërkimore (GMK). GMK e Menaxhimit të Turizmit dhe GMK e Të Drejtës dhe Sociologjisë perbehen me nga 5 anëtarë personel akademik secili.<br><br>Departamenti MTR, i plotëson kushtet për numrin e personelit akademik me tituj dhe grada që janë të përfshirë në strukturën e tij DMTR ka më shumë se 3 persona me tituj dhe grada Në mënyrë më të detajuar personeli akademik eshte si më poshtë:<br><br>1- Prof. Dr,<br>5- Prof. As,<br>3- Dr,<br>1- Msc<br>Ne total numi i personelit akademik ne kete department eshte 10.<br>[Evidenca 78 tabela nr 12 , e peronelit te njesise baze ]</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</td><td colspan="4">Programi i Programi i studimit në "Agroturizëm dhe Mikpritje" ka një koordinator i cili është përgjegjësi i departamentit. Kordinatori i programit te studimit, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<br><br>[Vizita ne institucion, RVB fq. 33.]</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ konstaton se Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| **Standardi II.3** | |
|---|---|
| **Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Ne lidhje me standardet, përgatitjen, organizimin dhe administrimin e ketij programi studimi, shtylla kryesore eshte rregullorja e njësisë kryesore. Të gjitha njësite bazë te FEA-s, harmonizojnë rregulloret e programeve të studimeve të tyre si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore. Ato mund të vendosin kritere shtesë, por ato nuk duhet të jenë në asnjë rast më të ulëta ose me minimale se kriteret bazë të kësaj rregullore. |

| | |
|---|---|
| | Programi i studimit në në "Agroturizëm dhe Mikpritje", funksionon në bazë të rregullores së vecante te ketij pogrami profesional 2 vjeçar Agroturizëm dhe Mikpritje, te vitit 2021.<br>**[Rregullore FEA, Rrregullore e programit të studimeve profesionale 2 vjeçare, agroturizëm dhe mikpritje, viti 2021]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit. | Programi i studimit në "Agroturizëm dhe Mikpritje" përmban informacionet e nevojshme për secilin nga lëndet, për praktikat, seminaret, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me legjislacionin ne fuqi.<br>**[ VKM nr. 41 , 2018, e ndryshuar, Rregullore e studimeve , Evidence nr.72 plani mësimore 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Ne rregulloren e njesise kryesore dhe ate te programit te studimit gjenden, të giitha informacionet e nevojshem per studentet, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike te pranimit, transferimit si dhe ekuivalentimin e studimeve. Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë të njohur studentëve kurrikulën e studimeve për të dyja vitet e studimit. Kjo kurrikul është e projektuar në mënyrë të tillë, që studentët ne përfundim të ciklit të studimeve jo vetëm të jenë të aftë të konkurrojnë në tregun e punës, por të kenë mundësi që të mund të ekuivalentojnë studimet ne rast se dëshirojnë që të studiojnë edhe ne ndonje program tjetër studimi.<br>Grupi i vleresimit nuk gjeti ndonje praktike te ekuivalentimit.<br>**[Evidenca 3, Rregullore Studime Universitare, RVB fq. 65-66]** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programet lendore (Sylabuset) jane hartuar bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Syllabusi i çdo lënde përfshin titullin e lëndës, emrin e pedagogut që është titullar i lëndës, tipologjinë e lëndës (*formim i përgjithshëm, karakterizuese etj.*), llojin e lëndës (*e detyruar ose me zgjedhje*), kodin e lëndës, adresën elektronike të titullarit të lëndës, rezultatet e të nxënit të pritshme nga ana e studentit, konceptet themelore të modulit, lista e temave të detajuara së bashku me literaturën bazë, forma e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të dijeve, literature e rekomanduar etj.<br>**[VKM nr. 41, 2018, e ndryshuar, Evidence 81 syllabuset e programit]** |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë. | Programi eshte ne vitin e dyte funksionimit dhe akoma nuk eshte pare e arsyeshme nga njesia baze qe ai te kete permisime. Ne takimin me koordinatorin e programit, na u tha qe po presin dhe anketimet e fundvititi dhe me pas ne rast se do kete nevoje, mund te kete vend dhe per ndryshime.<br>**[ Takimi ne institucion ]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *objektivat formuese të programit me karakter profesional sipas kornizes 5.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br><br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve. | Tërësia e moduleve të përfshira në këtë program studimi, përmbajtja e tyre, është në funksion të krijimit të njohurive dhe aftësive në fushën e ekonomisë dhe menaxhimit të ndërmarrjeve në përgjithësi, të fermave dhe ndërmarrjeve të biznesit në veçanti, me fokus menaxhimin e ndërmarrjeve turistike dhe në mënyrë specifike të turizmit alternativ të qëndrueshëm që zhvillohet në zonat rurale. Duke analizuar planin mesimor, silabuset dhe kurrikulen ne pergjithesi, mund te themi se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.<br><br>**[Evidence 71 plani mesimor, Evidence 81 Syllabuset, Evidence 74 Analizë e tregut tëpunës ]** |
| **Kriteri 2.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Shpërndarja e lendeve në semestra dhe vite është bërë në mënyrë të tillë që të mund të arrihen objektivat e studimit në këtë program. Në këtë rast, programi i studimeve profesionale 2 vjeçare në "Agroturizëm dhe Mikpritje" është formatuar i tille qe jo vetem mundësoje arritjen e objektivave formues të programit të studimit, por dhe rezultate të pritshme të të nxënit.<br><br>**[RVB fq. 39 ]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Referuar planit mësimor, është bërë një shpërndarje e lendeve me qëllim nje raport te balancuar teori me praktiken por dhe rritjen e nivelit të formimit profesional dhe që vazhdimisht do të jetë në përmirësim duke iu përshtatur kërkesave të kudrit rregullator. Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.<br><br>**[Evidence 71 plani mesimor, Evidence 81 Syllabuset ]** |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe | Shperndarja sipas veprimtarive te formimit teorik dhe praktik i cili mundëson arrtijen e objektivave formues dhe ndikimin në punësim të |

| | |
|---|---|
| raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | sudentëve eshte realizuar sipas legjislacionit ne fuqi. Procedura e transferimeve brenda programeve të UBT-së por edhe midis universiteteve të ndryshme rregullohet nga rregullorja e studimeve ne UBT. Ky program studimi nuk kishte ndonje praktike transferimesh.<br><br>**[Evidence 3 Rregullore Studime Universitare, VKM nr. 41 , 2018, e ndryshuar, Rregullore e studimeve , Evidence nr.72 plani mësimore 2021-2022]** |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. | Programet e lëndëve (silabuset) të programit të studimit nen vleresim mund të rishikohen, bazuar ne rregulloren e UBT-se. Njesise kryesore dhe te programit te studimit. Sipas dokumentacionit qe ne shqyrtuam ne viziten ne institucion përmirësimet dhe ndryshimet që bëhen në programe, përfshijnë të giitha zërat e programit të çdo lënde: *rishikim përmbajtjeje; kontrollin dhe heqjen e temave të zhvilluara paralelisht në module të ndryshme; pasurimi në përmbajtje dhe tematika bazuar në eksperiencën e mësimdhënies së stafit akademik përkatës; vlerësimin dhe rifreskimin e literaturës së konsultuar bazuar në feed-back-un e studentëve si nga anketat që realizohen në çdo semestër nga DMTR ashtu edhe nga feedback-u që japin studentët pedagogut që zhvillon lëndën gjatë semestrit.*<br><br>Rishikimi i literaturës bëhet me kujdes, me synimi pasurimit dhe përshtatjes së përmbajtjes, metodikës dhe informacionet me zhvillimet e reja dhe nevojat e tregut të punës.<br><br>**[Evidences 69 Rregullore e studimeve Evidence 81 Syllabuset e programit Evidence 41 Format pyetësori vlerësim procesit mësimor]** |
| **Kriteri 6.** Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit. | Zhvillimi i praktikës profesionale luan rol të rëndësishëm ne formimin e studneteve te ketij programi studimi. Kjo është pjesë e programit të studimeve dhe është e detyrueshme për të gjithë studentët në fund të ciklit të studimeve. Ne nuk kemi te dhene se si ajo eshte zhvilluar pasi do te jete pjese e semestrit te dyte te ketij viti akademik. Praktika synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve si dhe tu sigurojë përvojë praktike për t'i aftësuar në ushtrimin e aktivitetit profesional. Sipas rregullores se programit te studimit, Departamenti mban përgjegjësi për evidentimin e kompanive ose institucioneve të mundshme për kryerjen e praktikës profesionale, por studenti mund t'i propozojë gjithashtu departamentit vendin ku ai dëshiron që të kryejë praktikën.<br>Kompanitë ku do të zhvillohen praktikat dhe Fakulteti kane detyrime kontraktore midis tyre. Në lëndë specifike ose në varësi të temave të realizuara brenda programeve jane edhe ekskursione mësimore të studentëve së bashku me pedagogët e lëndëve kryejnë në institucione, kompani, biznese të profilit turistik ose edhe agroturistik, ferma, agroindustri, etj.<br>**[Evidences 69 Rregullore e studimeve ]** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e | Program i studimit nuk ka diplomuar akoma studentet e pare, por nga vleresimi i dokumentacionit qe GVJ realizoi, mund te themi se |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. | përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës ne Shiperi por edhe ne rajon. **[Vizita ne institucion]** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Programi eshte ne vitin e dyte funksionimit dhe akoma nuk eshte pare e arsyeshme nga njesia baze qe ai te kete permisime. Ne takimin me koordinatorin e programit, na u tha qe po presin dhe anketimet e fundvititi dhe me pas ne rast se do kete nevoje, mund te kete vend dhe per ndryshime. **[ Takimi ne institucion ]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Nga takimet me studentet e ketij programi studimi, na u transmetua qe ata jane te pershfire ne shume ceshtje qe kane te bejne me programin e studimit nen vleresim. **[ Takimi me studentet ]** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje | Programi eshte ne vitin e dyte funksionimit dhe akoma nuk eshte pare e arsyeshme nga njesia baze qe ai te kete permisime. Ne takimin me koordinatorin e programit, na u tha qe po presin dhe anketimet e |

| | |
|---|---|
| me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private. | fundvititi dhe me pas ne rast se do kete nevoje, mund te kete vend dhe per ndryshime.<br><br>**[ Takimi ne institucion ]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.P ermbushet plotesisht* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Nga vizita ne institucion dhe konsultimi i dokumentacionit ne kuader te vetevleresimit, veme re se format e transmetimit të njohurive tek studentët kanë qenë në mënyrë dinamike e në proces përmirësimi, përgjithësisht ato mund t'i konsiderojmë si elemente pozitive ne kete program studimi. Gjate vizites konstatuam se personeli akademik përdorte mjete bashkëkohore të mësimdhënies, siç janë mjetet audio-vizive, etj. Sigurimi nga ana e fakultetit të një numri të konsiderueshëm të këtyre pajisjeve, ka zgjidhur përfundimisht problemin e disponueshmërisë së tyre. Ky element ka stimuluar emancipimin, por edhe preferencën nga ana e studentëve për të realizuar detyra te ndryshme. Ky komunikim në auditor ka nxitur tërheqjen e vëmendjes nga ana e tyre, duke i përfshirë studentët në diskutime gjatë orës së mësimit, ne leksione apo dhe seminare.<br>Në programin e studimit "Agroturizëm dhe Mikpritje", format kryesore të mësimdhënies janë;<br>1. leksionet,<br>2. seminare<br>3. orët laboratorike<br>4. praktikat profesionale<br>Në total, në këtë program studimesh janë 1480 orë, nga të cilat për secilën formë të mësipërme janë:<br>• Leksione: 540 orë<br>• Seminare: 540 orë<br>• Praktika mësimore 275 orë<br>• Provimi final 125 orë<br>**[Evidence. 71 plani mësimor 2022-2023]** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke perdorur forma te ndryshme te mesimit si ne aspektin teorik ashtu dhe ate praktik. Ai përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin. Keto metoda nxitin mendimin krijues dhe kritik te studenteve. Fomat e mësimit teorik e praktik qe zhvillohen ne keto programe studimi janë: leksione, seminaret, praktikat profesionale, detyrat e kursit, etj. Keto metoda ofrojne mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.<br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve ]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe | UBT mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.<br>Në funksion të pëmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave |

| | |
|---|---|
| pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve. | më të reja të mësimdhënies, UBT ka investuar në teknologji të reja në mënyrë të vazhdueshme.<br>Në funksion të moduleve aplikative në këtë program studimi janë vënë në dispozicion salla të pajisura me kompjutera dhe softe te ndryshme.<br>Institucioni në politikën e vet të burimeve humane, ka një perspektivë të qartë për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik. UBT inkurajon, asiston personelin akademik për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore, si dhe në ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme, të cilat synojnë kualifikimin e mëtejshëm të tyre.<br>**[RVB fq.45]** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | UBT, ju siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, kanë sistem ngrohje, etj. Personeli akademik përdor projektorët për prezantime powepoint për dhënien e leksioneve dhe prezantimeve.Personeli akademik i angazhuar kete program studimi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. **[RVB fq. 47]** |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Departamenti, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.<br>Keto mendime vijne kryesisht gjate anketimeve qe zhvillon njesia e brendeshme e sigurimit te cilesise dhe nga vete departamenti.<br>Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësori i studentëve, të cilat analizohen edhe në analizën vjetore të departamentit.<br>**[Takimi me sudentet dhe vizita ne institucion, evidence 65. Analiza mësimore kërkimore 2021-2022]** |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të | Personeli akademik i programit te studimit perdor dhe është i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.<br>Ky personel përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënies te cituara me lart. Për shkak të karakterit praktik të disa moduleve, si pjesë e kurrikulës së programit "Agroturizëm dhe Mikpritje" në mënyrë periodike në orët e seminareve, studentët vizitojnë biznese të agroturizmit apo të turizmit rural, duke e bërë jo vetëm praktike e konkrete mësimnxënien, por edhe tërheqëse për studentët.<br>**[ RVB fq. , takimi me studentet ne institucion ]** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se departamenti pergjegjes per kete program studimi, garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive percaktohen ne rregulloren e njesise kryesore dhe ne rregulloren e programit te studimit. Vlerësimi i studentit ne kete program mesimor, ndahet në dy pjesë: Provimi i vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimi final.<br>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson 25% të vlerêsimin ne total. Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar dhe atij te vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog në syllabusin e tij. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale per kete program studimi behen publike dhe njihen nga studentet.<br><br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve, takimi me studentet ne institucion ]** |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. | Në fillim të çdo moduli të programit të studimeve të kursit dyvjeçar "Agroturizëm dhe mikpritja" të departamenit MTR, lektori ju ben me dije studentëve programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën, që do të përdoret në modulin përkatës.<br>Studentëve që në orët e para të leksioneve ju bëhet me dije struktura e lëndës më përqindjet në vlerësimet, ku dallojnë dy zëra kryesorë: ai i vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me provimin përmbyllës.<br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve ]** |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të | Ne kete program studimi, provimi është forma kryesore e kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve, që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lende te caktuar. Provimi zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar, sipas sillabusit perkates te miratuar ne departament. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike. | Kolokiumi është formë e kontrollit të përvetësimit të lendes që përfundon brenda periudhës së mësimit. Kolokiumi mund të përsëritet edhe brenda javës pasardhëse.<br>Kontrolli i dijeve gjatë procesit mësimor merr në konsideratë: pjesëmarrjen clhe angazhimin e studentit në leksione, seminare, ushtrime, punë laboratori detyra me shkrim (provime ndërmjetëse), detyra kursi, praktika mësimore, etj. Pavarësisht pikëve të grumbulluara, studenti që ka munguar apo është vlerësuar negativisht në detyrat e kursit apo në praktikën mësimore, është i detyruar t'i shlyejë ato javën e fundit të zhvillimit të proçesit mësimor.<br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve ]** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UBT ka hartuar rregullore te programit te studimit e cila ka te percaktuar qarte procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. | Ne kete program studimi testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.<br>Ne rregulloren e njesise kryesore jane te percaktuar qartë mënyrëa e vlerësimit të studentëve përgjatë gjithë semestrit akademik. Sic e kemi thene me larte, vlerësimi i studentit ndahet në dy njesi:<br>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson 30% deri në 50 % të vlerësimit total.<br>Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar giatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga personeli akademik në programin mesimor dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit. **[Evidence 28 Rregullore FEA ]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Universiteti Bujqësor i Tiranës ka bërë një marrëveshje me Fondacionin Shqiptaro Amerikan për Zhvillim, për të testuar njohurite me nje program elektronik, CleanScore.<br>CleanScore ka për qëllim të zbatojë në universitete korrigiimin e automatizuar të provimeve, duke rritur ndjeshëm transparencën në vlerësimin e studentëve. Ne takimin qe patëm me studentë, na u vu në dukje që disa provime ishin zhvilluar me këtë program elektronik.<br>**[Evidence 69 Rregullore e studimeve, takimi me student ]** |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me | Në këtë program studimi, nga vleresimi i bërë nga GVJ-ja, i disa praktikave të provimeve në institucion, vume re se vlerësimi |

| | |
|---|---|
| syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret e pergjithshme te UBT-se, njësisë kryesore dhe rregulloren e programit të studimit.<br>**[Evidence 28 Rregullore FEA, Evidence 69 Rregullore e studimeve]** |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Nga vleresimi i disa provimeve vume re se ne korrigjimin e testeve, pedagogu vendos komente per pjese te ndryshme te pyetjeve, qe studenti nuk i kishte zhvilluar te plota. Studenti bazuar ne rregulloret perkatese ka te drejte te shohe tezen e vet dhe kjo mundesi i garantohet.<br>**[Evidence 69 Rregullore e studimeve dhe takimi me studentet ]** |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Nga takimi me student gjate vizites ne institucion, na u konkludua se ne kete program studimi, personeli akademik dhe pergjegjesi i departamentit jane munduar te jene sa me korrekt qe te jete e mundur, ne lidhje me zbatimin e ligjit ne lidhje e me plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra, apo dhe elemete te tjera qe bien ne kundershtim me frymen universitare. **[Takimi ne institucion me studentet]** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Procedura e ndjekur nga departamenti per dhenien e provimeve per kete pogram studimi eshte si me poshte.<br>Rezultatet e provimit hidhen ne sistem brenda dy diteve, kur provimi eshte me goje dhe brenda 8 diteve kalendarike nga data e kryerjes se provimit, kur provimi eshte me shkrim ose me shkrim dhe goje.<br>**[Evidence 28 rregullore e FEA, takimi me studentet]** |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Proceduar e ndjekur per vleresimin dhe ankimin e studenteve eshte si me poshte. Pas shpalljes se rezultateve dhe hedhjes se tyre ne sistem, studenti ka te drejte te sqarohet per çdo paqartesi, ose te kundershtoje rezultatin e marre brenda dy diteve (48 ore). Komisoni i provimit eshte i detyruar te sqaroje studentin ne lidhje me vleresimin e bere, duke ballafaquar pergjigjet e dokumentuar te studentit me tezen e zgjidhur. Mbas ketij afati, nota konsiderohet perfundimtare dhe komisioni ka detyrimin te beje mbylljen perfundimtare te procesverbalit ne sistem brenda dy diteve.<br>**[Evidence 28 Rregullore FEA, takimi me studentet]** |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Per kete program studimi, bazuar ne rregulloret e Njesise kryeore dhe asaj te studimeve, studenti ka te drejten e ankimimit ne ato raste kur ai mendon se mund te jete penalizuar pa te drejte. Ankesa behet me shkrim brenda dites se zhvillimit te provimit, ose brenda 2 diteve (48 oreve) pas shpalljes se rezultatit, kjo kerkese i drejtohet Dekanit te fakultetit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegiësin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit, për të cilin studenti është ankuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve, që mbahet në dekanat<br>**[ 28 Rregullore FEA, takimi me studentet]** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.<br>Lëndët që bëjnë pjesë në kurrikulën e programit të studimit të "Agroturizëm dhe mikpritja" përfshijne njohuri, që japin formimin e përgjithshëm bazë, të cilat gradualisht në vitet pasardhëse thellohen, ne njohuri në fushën e turizmit rural, me njohuri aplikimi në biznese etj. Kjo kurrikul i drejton studentet e ketij programi studimi, qe t'i thellojnë më tej njohuritë e tyre ne te dy drejtimet, si menaxhimit të bizneseve turistike ashtu edhe të aspektin ekonomik te saj.<br>**[Evidence 69 Rregullore e studimeve, evidence 71-plani mesimor]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Në programin e studimit "Agroturizëm dhe mikpritje", 50% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësisë në fushën e menaxhimit të bizneseve të turizmit rural, si:<br>• "Komunikim Biznesi',<br>• 'Komuniteti Rural dhe Turizmi"<br>• "Sjellja e Konsumatorit Turistik",<br>• "Marketingu i Turizmit",<br>• "Menaxhimi i Akomodimit në Turizëm"<br>• "Agroturizëm",<br>• "Sistemet e kompjuterizuara të rezervimit në turizëm"<br>Në planin mesimor, jane edhe lëndë ndërdisiplinore, që zënë 14% të lëndëve të kurikulës, si dhe lëndë plotësuese.<br>**[Evidence 71, plani mesimor 2022-2023]** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo | Programi i studimit nen vleresim perdor si format, silabuset e miratuara ne Senatin Akademik sipas VKM-se numer 41, viti 2018, e ndryshuar. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e |

| | |
|---|---|
| lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | shqyrtohen në përfundim të vitit shkollor (*ne silabus eshte rubrika përmbledhje dhe rezultate e nxënurit*). **[Evidenca 63 Analiza mësimore kërkimore 2021-2022, Evidenca 81 Syllabuset e Programit]** |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Në përfundim, të çdo lende pedagogu i bën me dije studentët për modelin dhe formatin e tezës së provimit, që do të përdoret duke e shoqëruar me një listë të pyetjeve, që korespondojnë me çështjet më të rëndësishme të trajtuara në modul. Gjithashtu, pedagogët i informojnë studentët për lidhjen e lendes përkatës me shumë lende të tjera dhe nga ana tjetër i tregon se, ku mund të zbatojnë shumë tema të zhvilluara të kësaj lende në praktikë. Nje shembull eshte lënda menaxhim turizmi, e cila ndihmon studentin të implementojë teorinë nëpërmjet menaxhimit të bizneseve në praktikë. **[ RVB , fq .49]** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Në Planin e Aktiviteteve të UBT-se, një nga pikat është edhe zhvillimi i leksioneve të hapura nga personalitete të ftuara të fushës. Secili pedagog ne kete program studimi, sipas fushës përkatëse që mbulon ka ftuar në leksion një drejtues, specialist etj, i cili ka sjelle përvojën nga biznesi, aktiviteti i tij, etj. **[Evidence 3 Rregullore e pergjithshme e UBT, RVB fq. 49]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit dy vjecar, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5** | |
|---|---|
| **Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Institucioni ka hartura nje plan pune per cdo detyrim qe ai ka. Brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bëjnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit, nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe asaj të departamentit, ku informohen studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. **[Evidence 3 Rregullore e pergjithshme]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Personeli akademik ne kete program studimi eshte ne dispozicion te studenteve lidhur me detyrimet permbyllese dhe jo vetem. Ata ju vënë në dispozicion materialet e nevojshme të kërkuara prej tyre, si dhe ju vendoset në dispozicion një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit. Gjithashtu ju rekomandohen dhe materialet të cilat gjenden në bibliotekën e universitetit, por dhe të fakultet. Në të njëjtë kohë personeli akademik organizon edhe konsultime, nëse studentët e ndiejnë të nevojshme.<br>**[Takimi ne institucion me studentet ]** |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Studentëve të ketij programi studimi, që në fund të semestrit të I, ju vendoset në dispozicion një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit, ku ka midis tyre lëndë karakterizuese, për të dyja vitet e studimit.<br>Kjo listë gjendet në bibliotekën universitare në hard copy dhe studentëve nga ana e personelit akademik, ju tregohet ku ta gjejnë atë.<br>Në provimin e formimit rastet studimore në teza janë hartuar duke gërshetuar lëndët të profilit karakterizues të studimeve të programit "Agroturizëm dhe mikpritje". **[Evidence 71, plani mesimor 2022-2023]** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Brenda një muaj nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet Ju bëjnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe asaj të DMTR dhe informojne studentët rreth organizimit të provimeve të formimit.<br>Ne kete program studimi nuk ka teme perfundimtare, por provim te pergjithshem.<br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve ]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit. | Në fund të procesit mësimor studentët në bazë të negullores te Fakultetit, janë të detyruar të japin provim permbylles. Pedagogët ju ofrojnë studentëve një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit.<br>Studentët në dispozicion kanë edhe bibliotekën websitin e FEA s, por edhe të UBT s, ku mund të shkarkojne literaturë pa pagesë në ndihmë të realizimit me sukses të detyrimit përmbyllës të ciklit të studimit.<br>**[Evidence 69, Rregullore e studimeve ]** |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë. | Studentë e ketij programi në përfundim të studimeve, nuk mbrojnë temë diplome, por japin provim formimi. Ngrihet një komision prej 5 personel akademik të departamentit, të cilët testojnë dijet e fituara gjatë dy viteve të studimit dhe bëjnë vlerësimin me notë.<br>**[Evidence 69 rregullore e studimeve ]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Sipas legjislacionit ne fuqi dhe rregulloreve te institucionit, diplomimi bëhet me provim formimi. Tezat e provimit të formimit hartohen nga departamenti në bashkëpunim me pedagogët e lendeve. Provimet e formimit vlerësohen nga i njëjti komision vlerësimi. Komisionet e vlerësimit përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i FEA s.<br>Koha e nevojshme për përgatitjen e studentit është 60 minuta. Në përfundim të provimit studenti vlerësohet me notë. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e dhënies së provimit, në përfundim të ditës së provimit. Nëse tre nga anëtarët e komisionit bëjnë vlerësim negativ, atëherë studenti vlerësohet negativisht. **[Evidence 69 Rregullore e studimeve]** |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hard kopje, si dhe në databazën digitale, që tashmë disponon UBT, sistemi ESSE3. Dokumentacioni hard copy ruhet në ambjentete e UBT-s. Diplomat e studimit të kursit dyvjeçar "Agroturizëm dhe mikpritja" në Menaxhimin e Turizmit Rural, regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çeflifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Qendren e Sherbimeve Arsimore (QSHA).<br>Regjistrimi i diplomave bëhet në regjistrin shtetëror të diplomave qe njesia kryesore ka. **[Evidence 69 Rregullore e studimeve]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UBT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve të studentit dhe e pajis atë me diplomen përkatëse.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Ne rang institucional UBT harton cdo vit një plan masash për zbatim nga të gjitha njësitë kryesore dhe ato bazë. Ndër aspektet e ndryshme që janë pjesë e këtij plani masash, ka dhe rubrika për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies.<br>Gjithashtu, në UBT jane disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, pasi Universiteti Bujqësor i Tiranës ka adaptuar prej kohësh metodat e reja të mësimdhënies, (e-learning është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, moduli online "njohuri për informacionin", TEEAL etj).<br>**[Evidence 3, Rregullore e UBT, vizita ne institucion]** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse | Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të |

| | |
|---|---|
| zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | personelit akademik dhe ndihmës akademik nga ana e institucionit realizohet në mënyrë periodike si nga strukturat e rektoratit ashtu dhe nga ane e departamentit. Elementet kryesorë që mundësojnë këtë monitorim dhe vlerësimin, është realizimi dhe zhvillimi i pyetësorëve te parashikuar ne rregulloret perkatese. Ky pyetësor realizohet në përfundim të çdo semestri akademik. Gjithashtu, element tjetër që përdoret nga deparatementi, është dokumenti i performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore etj. **[Evidence 65 Analiza mësimore kërkimore 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka dy struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, e cila eshte Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Njesia e brendshme e sigurimit te cilesise ne nivle njesie kryesore. Misioni i tyre përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i giithë procesit mësimor, plus dhe berja publike e rezultateve te vleresimit. **[Evidenca 8, Rregullore e degës zhvillim Kurrikul Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Universiteti Bujqesor i Tiranes, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rastet e specifikuara si pozitive promovohen ne strukturat e ndryshme te UBT. Institucioni është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies ashtu dhe per përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Këtë rol ne UBT e kryen dega e zhvillimit të kurrikulave, karrierës clhe vlerësimit institucional, zyra e studimeve dhe studentëve, deparamtenti etj. **[ Takimi ne institucion, RVB fq. 69]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UBT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1<br><br>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | GVJ, duke u mbështetur në materialet e vëna në dispozicion si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton që personeli akademik që anagazhohet në realizimin e programit profesional 2-Vjeçare "Agroturizëm dhe mikpritje" ka nivelin e kërkuar akademik. Këtë e dëshmojnë CV e personelit akademik efektiv dhe me kontartë. **[Aneks 82 CV stafit akademik DPAM; Aneks 87 Tabela e fushës së ekspertizës-DPAM]**<br><br>GVJ konsultoi CV e tyre dhe konkludon që ata kanë arritje të vazhdueshme në fushën e kualifikimit dhe, me angazhimin e tyre në aktivitetet e kërkimit shkencor dhe botimeve, synojnë arritje të mëtejshme çfarë do ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. **[Aneks 82 CV stafit akademik DPAM; Aneks 83 Diploma dhe tituj të stafit akademik DPAM]** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Nga shqyrtimi i Tabelës 12.2 të ngakesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 rezulton së në programin e studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje" personeli akademik efektiv i angazhuar mbulon 87.5% të ngarkesë dhe personeli akademik me kontratë 12.5% të ngarkesës mësimore. **[Aneks 78 Tabelat përmbledhëse RVB_DPAM]**. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | UBT dëshmon nëpërmjet dokumentacionit shoqërues për qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. **[Aneks 53 Format Kontrat Pune]**.<br><br>Nga listë pagesat e vëna në dispozicion si për dy vitet e fundit dëshmohet mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik që shërben në këtë program studimi. **[Dokumentacion shtesë, Listë Pagesa Janar 2022; Liste Pagesa Dhjetor 2022; Listë Pagesa Janar 2023]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, | Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën e konkurimit. Shpallja e pozicionit të lirë të punës sipas kategorive **Profesorë, Lektorë dhe Asistent-Lektorë.** Vlerësimi kryhet nga një komision ad-Hoc i cili përbëhet nga tri përfaqësues nga njësia bazë, një nga DBNJ dhe një përfaqësues të rektoratit. Përzgjedhja kryhet mbështëtur në skdea vlerësimi për cdo kategori. Skeda përmban kriteret e pergjithëshme që janë dhe elminuese dhe kritere specifike që hartohen nga njësia bazë në varësi të nevojave që |

| | |
|---|---|
| strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | kanë. **[Dokumentacion shtesë, rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës dhe administartiv në UBT; Aneks 54 Proçedura e Rekrutimit]]**<br><br>GVJ konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.<br><br>**[Vizita në institucion Takimi me Drejtuesin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës në ambientet e Universitetit, përkatësisht laboratorëve, të cilët përdoren nga studentët, u shoqërua dhe u informua nga stafi ndihmës i universitetit (departamentit), i cili merrej ekskluzivisht me punën e laboratorëve. Kishte 3 laboratorë në dispozicion të shkollës profesionale 2-vjeçare AM, të paisur në kuadrin e realizimt të projekteve të objektivave të programit të studimit. Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike ishte në nivel shumë të mirë. **[RVB; Viziat në institucion]** |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ. | Institucioni mbledh, dokumenton dhe përditëson dosjen e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe koordinatorit të programit cdo vit. Në vizitën e GVJ në Zyrën e Burimeve njërëzore nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi së dosjet e tyre kishin të gjithë dokumentacionin (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, etj). Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik rezulton se personeli ka formim akademik të fushave që mbulon.<br><br>**[Vizia në institucion-takimi me drejtues së Zyrës së Burimeve Njerëzore]** |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UBT ka të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri multidisiplinore në përputhje me fushën e studimit, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e praktikës profesionale. **RVB**<br><br>UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me 62 institucionet qëndrore, vendore dhe sipërmarrje private për realizimin e praktikës profesionale, në përputhje me fushën e studimit të programit.<br><br>**[Aneks 91 Lista e Marrveshjeve UBT-Praktika Profesionale, QKA]** |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave | Në programin e praktikës profesionale të hartuar nga DPAM për, praktikat profesionale të ciklit të studimit profesional 2-vjeçare në UBT, është e përcaktuar në formën e një formulari kërkesa dhe |

| | |
|---|---|
| profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | kontartën që studenti duhet të paraqesë pranë biznesit në fillimin e realizimit të praktikës profesionale. **[Aneks 79 Dosja praktika Profesionale]**<br><br>Personeli mbikëqyrës ka si detyrë të asistojë studentin gjatë praktikë, ta mbështesë atë në përfitimin e njohurive dhe të bëjë vlerësimin e studentit për tregues të përmbledhur në formular dhe assiton studentin në hartimin e raportit përfundimtar. **[Aneks 79 Dosja praktika Profesionale; Takimi me drejtuesen e njësisë bazë]** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga vizita ne UBT, GVJ konstatoi se UBT disponon hapësira të mjaftueshme sipas standarteve shtetërore, komode, funksionale dhe të paisura me kompjutera, projektore, ëifi, etj, për realizimin me sukses të mësimit teorik dhe praktik. **[Aneks 66 Infrastruktura FEA faqja 3; Vizita ne IAL e GVJ]**. Të gjithë pedagogët kanë hapësirat e tyre personale të paisura me kompjutera si dhe studentët kanë hapësira të dedikuara për ata për përdorim kompjuterash, sallë leximi, biblioteken, kancelarine, etj, **[Vizita e GVJ ne UBT]**. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Në UBT, mjediset mësimore ku zhvillonin procesin mësimor studentët e shkollës profesionale 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje" garantonin realizimin e procesit mësimor. Mësimi zhvillohet në dy godina A dhe B. Në të dy godinat funksionojnë 14 salla leksioni me 1844 vende, 26 salla seminari me 976 vende. Salla me e madhe e lekisonit është Salla e Ligjëratave "Behar Male". **[Aneks 66 Infrastruktura FEA]**. Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me paisjen e sallave dhe laboratorëve me smartboard dhe sistemem projektimi digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të paisur me kompjutera, priter/ fotokopje/ skaner, projektor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm |

| | |
|---|---|
| | laboratorësh. **[Vizita e GVJ në institucion].** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Krahas sallave në FEA ka 8 laboratorë të tematizuar sipas funksioneve për zhvillimin e programeve të studimit. Për programin në fjalë shfrytëzohej Laboratori i Shkencave të Aplikuara dhe Laboratori i Informatikës së Biznesit të paisura më kompjutera dhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për praktikat. E gjithe infrastruktura laboratorike dhe kompjuterike është në dispozicion të studentëve dhe përdoret nga ata. **[Aneks 66 Infrastruktura FEA]**. Gjatë vizitës që GVJ pati me personeli akademik efektivë dhe me kontartë konfirmoi realizimin e punëve praktike në lëndën IT për turizmin. Në këto laboratorë studentët aftësoheshin në përdorimin e programeve Galileu dhe Amadeus për kryerjen e rezervimeve on-line dhe hapjen dhe krijimin e faqeve promovuese për turizmin. Efikasitetin e përdormit të laboratorit në aftësi profesionale u konfirmua edhe në takimin me studentët e këtij program të studimit.<br><br>**[Vizita e GVJ në institucion me personelin akademik efektiv dhe me kontratë; viziat me studentët e programit të studimit].**<br><br>**Shih kriteri 3** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të programit të studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje" është në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Ajo gjendet si në formë fizike ashtu edhe në në formë digjitale në bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit e cila vë në dispozicion 3900 tituj nga fusha e ekonomisë dhe bujqësë. Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën e titujve të librave për zhfrytëzimin e agroturizmit për qëllime mikëpritje dhe turizmëm dhe konfirmoi që ato janë pasuruar dhe ishin në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program. Krahas formës fizike biblioteka është e pasur dhe me katalogun on-line dhe shumëllojshmëri të burimeve elektronike.<br><br>**[RVB; Vizita në institucion]** |

| | |
|---|---|
| | **[Aneks 67 Informacion Biblioteka Shkencore].** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UBT disponon bibliotekën skencore "Mentor Përmeti" me sallën e librit tekniko-shkencor "Vasfi Samimi", sallën e periodikut dhe librit artistik dhe biliotekën shkencore të FEA, të cilat janë të aksesueshme për studentët gjatë gjithë kohës, ora 8-16, pa pagesë. Bibliotekat e FEA që është përgjegjëse për programin e studimit ka 100 poste studimi, 10 kompjutera, internet dhe ëireless, system ngrohje dhe ftohje ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. **[Aneks 67 Informacion Biblioteka Shkencore], [Vizitë e GVJ në IAL].** |
| **Kriteri 3.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Institucioni disponon në bibliotekën e tij një koleksion të pasur librash, periodikë, materiale jo libra duke përshirë përfshirë dhe libra të Irlandës (rreth 2100 libra) të përfituara nga projekti Tempus. Në bibliotekë ka prani më të shumtë të librave për ekonominë dhe bujqësinë, kontabilitet, financë e audit. **[Aneks 67 Informacion Biblioteka Shkencore]**<br><br>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi ekzistencën e një fondi tejet të pasur jo vetëm në tituj por edhe në fushat që program i studimit zhvillohet. Gjithashtu konfirmoi jo vetëm shumëllojshmërinë por edhe edicione të reja të disa prej botimeve në fushën e turizmit. **[Vizita e GVJ në bibliotekë].** |
| **Kriteri 4.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka e FEA garanton të drejtën e çdo studenti për, aksesim të biblotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin e literaturës fizike dhe ambjenteve të mjediseve të brendëshme dhe të jashtëme të saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i të gjithë hapsirës së bibliotekës me rrjetin wireless dhe të aksesohen në biblioteka on-line.<br><br>**[Takim i GVJ me Përgjegjesen e Departamentit, Takim i GVJ me studentët, Vizitë e GVJ në IAL].** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve. | Biblioteka është e paisur me kompjutera dhe programe ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. Bibliotekat e FEA që është përgjegjëse për programin e studimit ka 100 poste studimi, 10 kompjutera, internet dhe ëireless, system ngrohje dhe ftohje ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. **[Aneks 67 Informacion Biblioteka Shkencore].**<br><br>**Një arritje e bibliotekës është përfitimi i burimeve elktronike si**<br>1. **Edward Elgar Publishing**<br>2. **IOPSCIENCE**<br>3. **The company of Biologists [Aneks 67 Informacion Biblioteka Shkencore].**<br><br>Nga vizita në institucion GVJ pati mundësi të aksesoj në këto burime elektronike të cilat sjellin të reja e fundit në diskutimet shkencore dhe |

| | |
|---|---|
| | aksesushmerin ne arritjet e fundit të saj. **[Vizitë e GVJ në IAL].** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka është e aksesueshme për studentët gjatë gjithë kohës, ora 8-16, pa pagesë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.<br><br>**[Vizitë e GVJ në IAL].** |
| **Kriteri 7.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. | Pasurimi i fondit me literaturë dhe dhe rritja e aksesimit në bibliotekat on-linë është misioni i Bibliotekës së UBT. Drejtuesi i njësisë bazë bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e programit të studimit. **[Aneks 92 Print Screen email Biblioteka Shkencore]**<br><br>Gjatë vizitës në instutcion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shakallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. **[Vizita në institucion; Takimi me drejtuesen e njësisë bazë dhe drejtuesen e binliotekës].** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme) për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, | UBT dëshmon se ka sistem të menaxhimit. Zyra përgjegjëse për administrimin dhe shpërndarjen e informacionit në UBT është Dega e zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit institucional që funksionon në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën |

| | |
|---|---|
| nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. | e Shqipërisë, Statutin e UBT-së, Rregulloren e DZHKKVI e cila ruan në hard copy dhe në formë elektronike të gjithë databazën lidhur me regjistrimin, frekuentimin, vlerësimin, diplomimin, etj., të studentëve.<br>**[Aneks 2 UBT statuti 2021; Aneks 8 Rregullore e degës së Zhvillimit Kurikul DZHKKVI-UBT; RVB]** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Zyra e Burimeve njerëzore, protokollit dhe arkivit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br>**[Aneks 5 Rregullore e rekrutimit-2018, protokollit dhe arkivit, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkepunuese, Vizitë e GVJ në Zyrën e burimeve njerëzore** |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | UBT disponon sistem menaxhimi të brendshëm PITAGORA që siguron akses në mësimdhënie për personelin akademik por është ende në punë e sipër krijimi i aksesit për studentë. **RVB**<br>Krahas sistemit PITAGORA aksesi në informacion realizohet edhe nëprmjet website të UBT. Këtë GVJ e konfirmoi duke hyrë në adresën **https://www.ubt.edu.al**<br>GVJ nga takimi që zhvilloi me studentë dhe personelin akademik dëshmuan për funksionimin e sistemit, shërbimin që merrnin prej tij dhe lehtësirta që ai u krijonte në komunikimin student-lektor dhe anansjelltas. **[Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore, takim i GVJ me studentët dhe stafin akademik].** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të ballafaquar edhe me **RVB** rezulton se çdo personel akademik që shërben në programin e studimit professional 2-vjeçar “Agroturizëm dhe Mikëpritje” ka në sistemin PITAGORA një llogari në të cilën hedh dhe ruan informacion për frekuentimin, vlerësimin dhe realizimin e detyrave dhe projekteve të hartuara nga studentët. **[Aneks 94 Print Screen Sistemi Pitagora; Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore dhe stafin akademik].** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi i menaxhimit të brendëshëm PITAGORA mundëson monitorim në kohë reale të informacionit si për aktivitetin e kryer nga personeli akademik lidhur me procesin mësimor ashtu edhe për veprimatrinë e kryer nga personeli administartiv dhe ndihmës administartiv. **[Aneks 33 Manual Përdorimi Sistemi Pitagora]**<br>Referuar dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se struktura dhe forma e funksionimit të stitemit mundëson hartimin e raportimeve si në nivel individual ashtu edhe në nivel programi lidhur me çështje si regjistrimi i studentëve, frekuentimit, arritjeve dhe saktësisë së punës nga punonjësit administrativ. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që | GVJ hyri në faqen e institucionit referuar adresës në RVB dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. | konstatoi publikimin e aktiviteteve të realizuara nga institucioni në kuadër të permbushjes të programit të studimit professional 2-vjeçar "Agroturizëm dhe Mikpritje"<br><br>**https://www.ubt.edu.al** | | | |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit profesional 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje".* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Institucioni UBT dëshmon se harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje". Në planin Strategjik të UBT, pika 3.16 nënvizohet se të ardhurat dhe shpenzimet në UBT evidentohen dhe regjistrohen sipas zërave dhe sipas njësive që i kanë krijuar dhe përdorur ato. Analiza e kostove dhe përfitimeve për çdo zë është pjesë e buxhetimit dhe e realizimit të buxhetit. **[Aneks 14 Plani Stategjik i UBT 2016-2025]**<br><br>Paraqitja e raportit financiar bëhët kryhet në kuadër të hartimit të planit buxhetor institucional afatmesëm në të cilin paraqitet kostoja mesatare e programit të studimit në varësi të grantit të dhënë nga MAS dhe numrit të studentëve të regjistruar. **[Aneks 68 Relacion mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm-UBT.].** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe | Nga dokumentacioni shoqërues ka vetëm një dukument që përmbledh realizimin e buxhetit për FEA për vitin 20210 dhe planifikimin për vitin akademik 2022. **[Aneks 68 Relacion Buxheti-2021-2022]**<br><br>*Por GVJ konstaton se nuk ka një dokument përmbledhës që të paraqesë masën e financimit për burimet njerëzore, shpenzimet operative, mirëmbajtjen e mjedisit, shpenzimet për bibliotekën, grandet vendase apo të huaja për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje"* |

| | |
|---|---|
| pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | UBT dëshmon se kryen auditim të brendshëm periodik. Për realizimin e këtij procesi institucioni ka hartuar rregullore e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor të Tiranës. **[Aneks 13 Rregullore Aditit i Brendëshëm-UBT]**<br><br>*GVJ nuk konstaton ndonje dokument në formën e raportimit nga procesi i ndonje auditimi të realizuar më parë.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Dokumentacioni shoqërues përmban relacion për realizimin e buxhetit për vitin 2021-2022 në nivel të njësie kryesore, FEA, në të cilin përshkruhet në vlerë numerike masa e shpenzimeve të kryera për paga, orë mësimore, për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, mbi ngarkesë mësimore, pagesat e personelit akademik të ftuar, shtesa funksionesh akademik, bursa dhe parashikohen shpenzimet për vitin e ardhshëm akademik. **[Aneks 68 Relacion Buxheti-2021-2022]**<br><br>***GVJ sygjeron hartimin e relacioneve të ngjajshme edhe per nivel të programit të studimit.*** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ konstaton se mungesa e një dokumenti përmbledhës që të paraqesë masën e financimit për burimet njerëzore, shpenzimet operative, mirëmbajtjen e mjedisit, shpenzimet për bibliotekën, grandet vendase apo të huaja për programin e studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje" e bënë të vështirë vlerësimin e shkallës së qëndrueshmërisë financiare për këtë program. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje". Gjithashtu konstaton se, nuk ka një document përmbledhës që të paraqesë masën e financimit për burimet njerëzore, shpenzimet operative, mirëmbajtjen e mjedisit, shpenzimet për bibliotekën, grandet vendase apo të huaja si dhe konstaton* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *mungesë dokumenti në formën e raportimit nga procesi i ndonje auditimi të realizuar më parë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Programi i studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje" zhvillohet në përputje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e UBT-së, me rregulloren e UBT për Studimeve Univeristare, rregulloren e FEA në UBT, rregulloren e programit të studimit. **[Aneks 2 UBT Statuti 2021; Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare; Aneks 28 rrefullore FEA 2017; Aneks 69 regullore e studimeve DMTR-DPAM]**. Rregullorja e UBT për studimet universitare është dokumenti në të cilin rregullohet zhvillimi i studimeve në UBT-të. Në të përcaktohen qartë të gjitha njësitë, rolet dhe përgjegjësit e përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të programit. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumentave te tjera te UBT dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjat gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni, (neni 2, efekti juridik).<br><br>**[Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare]** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Referuar rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe evidencave të tjera shoqërues strategjik dëshmojnë se një ndër parimet e funksionimit të UBT lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazin dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student të programit të studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje". Referuar rregullores së FEA, neni 42 të UBT dëshmohet se studimet në programin professional 2-vjeçare AM mund të ndiqen nga shtetas shqiptar, nga trojet etnike dhe nga shtetas të huaj.<br><br>**[Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare; Aneks 28 rrefullore FEA 2017; Aneks 69 regullore e studimeve DMTR-DPAM].** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Kriteret përcaktohen nga njësia bazë përgjegjëse për programin dhe i bëhet me dije QSHA nga FEA. **[Aneks 28 rrefullore FEA 2017]**. Referuar nenit 22 të rregullores së studimeve në UBT në këtë program studimi mund të transferohen shtetas të huaj dhe shqiptar. **[Aneks 69 regullore e studimeve DMTR-DPAM]**. E gjithë struktura organizative e UBT-së është në shërbim të studentëve në çdo fazë të studimeve dhe karierës pa dallime. **RVB**<br><br>GVJ e konfimoi këtë edhe në takimin që zhvilloi me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e | Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe |

| | |
|---|---|
| pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | dokumentacionit shoqërues GVJ konfirmoi ekzistencen e kritereve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me proçedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.<br><br>**[RVB; Aneks 55 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Pranimi për programet e studimit në UBT të çdo kandidati që ka përfunduar ciklin e mesem arsimor duhet të plotësojë këto kritere:<br>- Kriteret e meritës (mesatren e përcaktuar nga MAS)<br>- Kriteri i rëndësisë (koefiçenti shkollës së mesme nga vjen i përcaktuar nga FEA).<br>- Notës mesatare të lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë)<br>- Kuotave të paracaktuara nga FEA<br>Formula e përllogaritjes **[Aneks 55 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023]**<br>Institucioni dëshmon se nuk aplikon kritere shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. **[Takimi me drejtuesen e njësisë bazë gjatë vizitës në institucion]** |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se UBT zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihëm/bursave për shtresat në nevojë.<br><br>**[Aneks 60 njoftim për përjashtim nga tarfat e shkollimit; Aneks 61 njoftim për bursa studimi].** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin për shkollën profesionale 2-vjeçare "Agrotutizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konstatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. **[Aneks 69 rregullore e programit të studimit DMTR-DPAM; Aneks 28 rregullore FEA 2017]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. | Në UBT studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashte vendit. E gjithë kjo procedur është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në rregulloren e transferimeve, rregulloren e programit të studimeve si dhe nga Guida e FEA-s por edhe pranë zyrave të ZSS.<br><br>**[Aneks 69 rregullore e programit të studimit DMTR-DPAM; Aneks 28 rregullore FEA 2017; RVB]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Informimi i studentëve lidhur me kriteret e proceduart e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:<br><br>- Nëpërjet rregulloreve të programit të studimit,<br>- Nëpërmjet praktikës së informimit të studentëve të viti të parë të programit DMTR<br>- Nëpërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde.<br>- Nëpërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri<br>- Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen on-line nga studentët.<br><br>Gjithashtu, në lidhje me diplomimin eksizton një informacion i shprehur përmes rregullores së studimeve.<br><br>GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me proceduarat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me student në ditët e vizistës në institucion. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit. | Institucioni UBT ka hartuar rregullore të Studimeve e cila në Kreun IV "Studimet e Ciklit të Parë në UBT", në Nenin 27, 28, 29. Studentët njihen me këtë dokument në fillim të semestrit të dytë nga drejtuesi I njësisë bazë. Informacionin gjithashtu mund ta marrë pranë zyrave të ZSS. **[Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare; RVB]**<br><br>Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi se instiucioni nëpërmjet strukturave përkatëse kryente informimin për proceduart e punimit të diplomës dhe diplomimit. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Mbështetur në strategjinë e marketingut dhe të rekrutimit UniBa planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Disa prej natyrës së aktivitetve janë:<br>- Konferencë me mësuesit në karrirë të gjimnazeve dhe jo vetëm;<br>- Konferencë me maturantët;<br>- Vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit parauniversitar;<br>Në çdo fillim të vitit akademik UBT zhvillon "Javën e orientimit" për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm.<br>**[RVB; vizita në institucion takimi me drejtuesen e njësisë bazë dhe personelin akademik]** |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit për programin e studimit profesionale 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzjatjen e programit të studimit.<br>1. Nëpërmjet sesionit informues që realizohet në fillim të ciklit të parë të studimit.<br>2. Nëpërmjet rregullores së programit të studimit<br>3. Nëpërmjet syllabuseve lëndorë.<br>4. Nëpërmjet personelit akademik të DMTR.<br>5. Nëpërmjet afishimeve në këndin e njoftimeve në hollin e FEA.<br>**[RVB; Vizita në Institucion]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Që në momentin e regjistrimit, studenti pajiset me programin e studimit që përmbanë lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes Guidës FEA-s, systemin PITAGORA dhe personelit akademik që realizon programin.<br>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni |

| | |
|---|---|
| | kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimin dhe detyrat detyrat që dotë zhvillohen gjatë kursit, nëpërmet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri. Kjo vlerësohet si një punë shumë e mirë që bëhet nga ana e instituicioni për vrojtimin në mënyrë sistematike të masës me të cilën përmbushet marrja e informacionit nga studentët. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon panaire të tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. **[Aneks 26 Fletëpalosje FEA; Aneks 33 Manual i përdorimit të sistemit PITAGORA; RVB; Takimi me përfaqësues të Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo ZSS. **[Vizita në Institucion, takimi me studentë, RVB]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Fillimisht studentët informohen nga MTR në bashkëpunim me DZHKKVI për listën e subjekteve që FEA ka marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale nga të cilat 58 sipërmarrje agrobiznesi, 48 institucione publike dhe 2 organizata jo fitim prurëse. Të gjitha këto në përputhje me fushën e studimit të program. **[Aneks 76 listë institucionesh e marrëveshjesh UBT]** Një rol të rëndësishëm në këtë process laun edhe zyra e Karrierës së Studentëve e cila referon tek student çdo kërkesë të ardhur nga subjektet për praktika profesionale. **[RVB]**<br><br>Gjatë takimit që patëm me studentët e programit të studimit në institucion u konfirmua mbështetja e institucionit në informimin dhe mbështetjen për tu krijuar mundësi punësimi. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton përmbushejn e të gjithë kritereve lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, nga ana e UBT, FEA për programin profesional 2-vjeçare në AM.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi V.4<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit profesionale 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje". Institucioni disponon statistika për studentët e registruar në vitin akademik 2021-2022, 2022-2023 në Zyrën e Informacionit dhe Statisikës dhe Zyrën e Studimeve dhe Studentëve. Nga shqyrtimi nuk rezulton student i larguar.<br><br>**[Vizita në institucion-Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]** |
| **Kriteri 2.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të registruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Institucioni disponon të dhëna për dy vitet akademike për programin e studimit profesional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje". Gjithashtu përmes sistemit PITAGORA institucioni i disponon statistikat në çdo kohë. **[Minutat e Vizitës; Takimi në sekretarinë mësimore; RVB]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Sistemi PITAGORA bënë të mundur krijimin shikimin dhe përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave për veprimtarinë e personelit akdamik të UBT, studentëve dhe personelit ndihmës akademik. Nga të dhënat që gjeneoron ky sistem strukturat në nivele drejtimi kryejnë vlerësime dhe kontrollojnë saktësinë e informacionit. Vlerësimi iu përcillet departamenteve, dekanateve dhe rektoratit për veprime të mëtejshme. Krahas sistemit të menaxhimit të brendëshëm UBT menaxhon të dhënat statistikore të edhe përmes sekretarisë mësimore e ZSS të cilat kanë të dhënat personale të studentëve, numrin e telefonit, adresat e email-it, dhe ruan kontakete me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi në mënyrë diskrete dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat TI-it të autorizuar në fakultet dhe rektorat. **[RVB; Vizita në institucon]** |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit | Për programin e studimit professional 2-vjeçare "Agroturizëm dhe Mikëpritje", njësia bazë përgjegjëse për të ka realizuar një analizë mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ky dokument analizon komponent të ndryshëm të këtij programi studimi. **[Aneks 62 Analizë mësimore kërkimore 2020-2021-FEA; Aneks 63 Analizë mësimore kërkimore 2021-2022-FEA; Aneks 66 Analizë mësimore kërkimore 2019-2020-FEA] [Aneks 24 raport Gjurmimi Punësimi shkurt 2021]** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të këtyre treguesve. | GVJ e konfirmoi hartimin e raporteve si nëpërmjet dokumenteve ashtu edhe në takimin me përgjegjësin e njësisë bazë të programit të studimit dhe takimin me personelin akademik. | | | |
| **Konkluzione** | *Kriteret lidhur me vlerësimin e administrimit, përditësimit dhe ruajtjes së të dhënave të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre janë të justifikuar me dokumentacion të bollshëm mbështetës dhe argumentues.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi V.5** <br> **Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Bazuar në Statutin e UBT, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: <br> A. 1 student në Bordin e Administrimit <br> B. 3 studentë në Senat Akademik; <br> C. Këshilli i Studentëve; <br> D. Këshillat e Studentëve në nivel njësie kryesore; <br> E. Komisioni I Sigurimit të Cilësisë Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor; <br> Dokumentacioni shoqërues tregon se UBT është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademi, në Bordin e Adminsitrimit, në Komisionin e Etikës, në komisionet zgjedhore, në zgjedhjet për Rektorin e universitetit dhe Dekanin e Fakultetit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e UBT, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri. <br> Nga shqyrtimi i disa modeleve pyetësorësh GVJ konstaton se studentëve Ju kërkohet të vlerësojnë sipas rubrikave: <br> ***Lëndët e zhvilluara***: <br> 1. Lëndë të përshtatëshme për programin e studimit <br> 2. Lëndë të vështira <br> 3. Lëndë të papërshtatshme për programin e studimit. |

| | |
|---|---|
| | 4. Lëndë që ju aftësojnë praktikisht<br>5. Lëndë që përmbajnë informacion bashkëkohor<br>***Realizimin e orëve:***<br>A. Realizimi i leksioneve<br>B. Seminareve<br>C. Diskutimeve<br>***Vlerësimin e performancës së personelit akademik:***<br>1. Përdorimin e metodave<br>2. Motivimin e studentëve<br>3. Vlerësimin e studentëve<br>4. Respektin ndaj studentëve<br>***Vlerësimin e materialeve mësimore:***<br>1. Materialet mësimore janë të përshtatëshme për lëndën<br>2. Biblioteka është e pasur<br>3. Interneti përdoret në funksion të mësimit<br>**4.** Teknologjia mësimore përdoret në funksion të mësimit **[Aneks 40 Pyetësori ON-LINE UBT-2019; Aneks 41 Format Pyetësor Vlerësimi Procesit Mësimor FEA]**<br><br>Pyetësori studentor hartohet në bashkëpunim midis sektorit të kurikulave dhe sigurimit të cilësisë. Pyetësori siguron anonimatin e studentit. GVJ konstaton se institucioni jo vetëm që përfshin student në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspect të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm për të hartuar raporte të cilat analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve në fund të çdo semsetri. Në këtë pyetësor, ka një rubrikë e cila titullohet "Lëndët e zhvilluara". Në këtë rubrikë studentët nëpërmjet pyetjeve të shtruara në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me:<br>1. Sa të dobishme janë materialet lëndor;<br>2. Qartësia e mënyrës së shpjegimit të leksioneve;<br>3. Qartësia e mënyrës së shpjegimit të seminareve/ushtrimeve;<br>4. Vlerësimi i rregullsisë së mësimit;<br>5. Gadishmërinë e pedagogut për tu spjeguar për pyetjet në lidhje me procesin mësimor;<br>6. Mardhëniën e pedagogut në lidhje me kodin e etikës;<br><br>**[Aneks 41 Format Pyetësor Vlerësimi Procesit Mësimor FEA]**<br><br>GVJ në takimin me drejtuesen e njësisë bazë përgjegjëse për programin u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit të procesit akademik si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | studentët. **[Takimi me drejtuesin e njësisë bazë, vizita në institucion]** | | | |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga kqyrja e dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Universitetit, përcaktohet procedura në rast ankese nga studenti. Sipas kësaj procedure, studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës në tezë. Drejtuesi i njësisë bazë ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë drejtuesi i njësisë, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar...etj **[Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare; Aneks 28 rrefullore FEA 2017; Aneks 69 regullore e studimeve DMTR-DPAM; Takimi me studentët; RVB]** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se standarti V.5 plotësohet plotësisht. Gjithashtu kriteret përmbushen të gjitha duke u mbështetur në dokumentacion të bollshëm argumentues.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e informimit pranë FEA dhe sekretaria mësimore, të cilat ofrojnë shërbim ditorë të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas sekretarisë funksionon edhe njësia e DZHKKVI e cila nëprmjet njësië vartëse QKA përkatësisht Zyrës së Karierës së Studentëve. ofron shërbime për të gjitha kërkesat, paqartësitë, procesin e këshillimit, informimit dhe ndjekjen e studentëve.<br>Sistemi i online PITAGORA luan rolin e sekretarisë online. Ai bënë të mundur përmbushjen e të gjitha detyrimeve të procesit mësiomor të parashikuara në rregulloren e UBT-s.<br>Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit të FEA u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të UBT. **[Aneks 8 Rregullore e Degës së Zhvillimit Kurrikul DZHKKVI-UBT;** **Aneks 3 rregullore e Studimeve Universitare; Aneks 33 Manual Përdorimi Pitagora]** |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur | Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan DZHKKVI e cila |

| | |
|---|---|
| dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UBT-s. **[Aneks 8 Rregullore e Degës së Zhvillimit Kurrikul DZHKKVI-UBT]**<br>Format e shërbimit që ofron për studentë janë Informin dhe Orientim profesional siç është informimi për praktika profesionale. ***[Aneks 8 Rregullore e Degës së Zhvillimit Kurrikul DZHKKVI-UBT; Aneks 20 Performanca e QKA 2022]***<br>Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Agroturizëm dhe Mikëpritje mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore lokale dhe në bashkëpunim me Bordin e Biznesit. Njëherazi prej studentëve morrën vlerësime rreth cilësisë së shërbimit prej kësaj njësie.<br>**[Takimet me student; Takimet me përfaqësues të QKA dhe ZKS]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Qendra për Këshillim Studentor u ofron studentëve informacion dhe orientim të posaçëm për procesin mësimor, praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.<br><br>**[RVB; Aneks 8 Rregullore e Degës së Zhvillimit Kurrikul DZHKKVI-UBT;Aneks 21 Panairi i Karrierës-2022; Aneks 21 Panairi i IV i Karierës; Aneks 25 Ftesë Panairi VII 2022]** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se procesi i gjurmimit të studentëve kryehet si nëpërmjet email-ve personale, telefonatave dhe faqes së zyrës së ZKS.<br>**[RVB; Aneks 24 Raport Gjurmimi dhe Punësimi Shkurt 2021; Aneks 21 Panairi i IV i Karierës; Aneks 21.1 Skedë Punësimi]** |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se kriteret përmbushen tërësisht duke konkluduar se standarti V.6 plotësohet plotësisht.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter professional ne "Agroturizëm dhe Mikpritje" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Bujqësor i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit profesional dy vjecar "Agroturizëm dhe Mikpritje", është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional sipas kornizes 5. Ai është unik në sistemin universitar shqiptar.
2. Programi i studimit profesional dy vjecar "Agroturizëm dhe Mikpritje", garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale.
3. Plani mësimor, silabuset dhe në pergjithesi kurrikula e këtij programi janë në përputhje me politikat kombëtare për zhvillimin ekonomik të vendit, atë të zhvillimit të turizmit.
4. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë krijimin dhe thellim e njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.
5. Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit
6. Nivel i lartë professional i personelit akademik që shërben në këtë program studimi, ku më shumë se gjysma e tyre kanë titulin Professor. Ky fakt është garanci për nivelin e komptencave profesionale që trasmetohen tek studentët.
7. Aftësimi praktik i studentëve në laboratorë me programe profesionale të cilët ndihmojnë në pregatitjen e studentit me aftësi profesionale të nevojshme për tregun e punës.

**Pikat e dobta:**

1. Mos hartimi i raporteve periodike nga ana e institucionit për realizimin e proceseve audituese të brendshëme dhe të raporteve financiare për masën e financimit për burimet njerëzore, shpenzimet operative, mirëmbajtjen e mjedisit, shpenzimet për bibliotekën, grandet vendase apo të huaja për programin e studimit. **(Standarti IV.5, kriteri 2)**

**Rekomandime:**

1. Harimin e raporteve periodike që të përmbajnë punën dhe rezulatatet e punës nga auditimi i brendëshëm i programit të studimit dhe raporteve financiare te detajuar për programin e studimit.
2. Promovim i arritjeve të programit drejtpërdrejt me grupet e interesit.

**Evaluation's conclusions for the professional study program " "Agritourism and Hospitality" provided by the Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"**

**Strengths and affirmations:**

1. The two-year professional study program "Agritourism and Hospitality" is detailed, informative, structured and organized in accordance with the predictions and formative objectives of the program with a professional character according to framework 5. It is unique in the Albanian university system.

2. The two-year professional study program "Agritourism and Hospitality" guarantees the growth of creative and implementation skills in students and aims at the in-depth development of professional competences.

3. The teaching plan, syllabi and in general the curriculum of this program are in accordance with the national policies for the economic development of the country, that of the development of tourism.

4. The content of the activities, the distribution of subjects and practices, enable the creation and deepening of knowledge and professional skills towards the employment of students.

5. About 25% of the program is dedicated to training in practice and the theory-practice ratio is in accordance with the profile of the study program.

6. High professional level of the academic staff serving in this study program, where more than half of them have the title of Professor. This fact is a guarantee for the level of professional competences that are transmitted to students.

7. Practical training of students in laboratories with professional programs that help prepare students with professional skills necessary for the labor market.

**Weaknesses:**

1. Failure to draw up periodic reports by the institution for the implementation of internal audit processes and financial reports on the amount of funding for human resources, operating expenses, environmental maintenance, library expenses, local or foreign grants for the study program . **(Standard IV.5, criterion 2)**

**Recommendation:**

1. Preparation of periodic reports containing the work and work results from the internal audit of the study program and detailed financial reports for the study program.

2. Promotion of program achievements directly with interest groups.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |